| Nr. | Drejtoria/Struktura | Detyrat funksionale të drejtorisë | Drejtori |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse | Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka përgjegjësitë dhe detyrat si vijon:<br>• Harton projektbuxhetin afatmesëm dhe vjetor të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, në bashkëpunim me njësitë e tjera organiztiave të ASPA-s.<br>• Ndjek dhe zbaton buxhetin e miratuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor dhe me objektivat e ASPA-s.<br>• Kontabilizon pagat dhe dokumentacionin tjetër financiar.<br>• Identifikon dhe plotëson nevojat e nëpunësve të ASPA-s për mbarëvajtjen normale të punës në ambientet e institucionit.<br>• Menaxhon burimet njerëzore të ASPA-s dhe administron dosjet e personelit.<br>• Administron dokumentat zyrtare hyrëse dhe dalëse të ASPA-s.<br>• Kryen përpunimin tekniko shkencor të dokumentave zyrtare në përputhje me udhëzimet e dhëna.<br>Merr në administrim dhe kujdeset për ruajtjen e bazës materiale. | **Daniela Ndrejaj** mban pozicionin e Drejtoreshës së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse. Ka kryer studimet e larta Master në "Audit-kontabilitet", në Fakultetin Ekonomik të Tiranës dhe "Banka-Tregje Financiare", në Universitetin Evropian të Tiranës. Ndërsa studimet Bachelor i ka përfunduar në degën Financë Bankë.<br>Daniela ka eksperienca pune në sektorin publik dhe atë privat, ku përmendim: Alpha Bank, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik, Ministria e Financave (Drejtoria e Auditimit të Brendshëm), Baker Tilly Albania (Audituese), Ministria e Drejtësisë dhe aktualisht në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).<br>Daniela është certifikuar si Audituese Publike (Ministria e Financave dhe Ekonomisë) dhe aktualisht është kandidate në stazhin e Audituesve Ligjorë (Instituti i Eksperteve Kontabël të Autorizuar). |